



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 482/ prot.

Memaliaj më 27-02.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 27.02.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në katin e parë të Bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit bashkiak Z. Erjon Sinanaj.

Mbledhja fillon në orën 10:30.

Këshilltarë të pranishëm 8 këshilltarë në momentin e fillimit të mbledhjes.

Të pranishëm nga administrata: Besnik Caushi/ Drejtor finance, Laora Hoxha/Përgjegjëse e shërbimit social, Xhuvana Kuçi/ Juriste.

● Pika e parë e rendit të ditës: "Miratimi i rendit të ditës.

Njohja me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.01.2025.

3. Informacion mbi vendimet e mbledhjes së datës 27.01.2025.

4. Projekt vendim " Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit bashkiak Memaliaj për vitin 2024".

5. Projekt vendim " Mbi dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 0-31 janar 2025".

6. Projekt vendim " Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajt janar-shkurt 2025".

7. Projekt vendim " Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve "

8. Projekt vendim " Për miratimin në parim për rritjen e numrit me 6(gjashtë)punonjës të strukturës së Sektorit të MZSH-së Bashkia Memaliaj. "

9. Projekt vendim " Për miratimin e shpërndarjes së të ardhurave trashëguara të vitit 2024 për vitin 2025."

Vjen në mbledhje Z. Esmerald Xhemali.

Hidhet në votim. Votohet unanim . Miratohet.

- Pika e dytë e rendit të ditës " Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar "

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota

Vota Kundër 0 Vota

Vota Abstenim 1 votë. Xh. Kacorri. Nuk kam qenë në mbledhjen e kaluar. Miratohet.

- Pika e tretë e rendit të ditës.

Informacion mbi vendimet e mbledhjes së datës 27.01.2025 sipas shkresës nr. prot. datë....

Z.Petrit Lumani:Vendimet me karakter individual si veprohet e kam pyetje.

Xh.Kuçi/Juriste: Në rast se prefektura shprehet me karakter individual është kompetencë e bashkisë të vazhdojë me procedurën. Unë mendoj se e keni pyetjen për Margarita Sh.p.k ,unë kam sjellë një relacion tjetër sot, që kërkojmë ta diskutojmë sot.

Z. Erjon Sinanaj: Pasi është mbyllur rendi i ditës keni dërguar te zyra e sekretares një relacion dhe projekt vendim që nuk përputhet me vendim marrjen e parë për mua relacioni nuk futet në rend dite sepse është i pa qartë.

Vjen në mbledhje Znj.Lauresha Lila.

Esmerald Xhemali: Këto vendime që kthehen me karakter individual, pse shkojnë në prefekturë?

Eriola Allka/ sekretare këshilli: Disa vendime kanë diskutim dhe për një kontroll tjetër ligjor ,unë mendoj t'i dërgoj në prefekturë për të qënë më të sigurt për një vendimmarrje të drejtë.

Taulant Rama:Në lidhje me vendimet individuale bashkia e ka fakultative apo obligim ti zbatoj?A ka të drejtë bashkia të mos i zbatoj?

Xh.Kuçi / Juriste: Kjo është në dashamirësinë tonë për ti zbatuar kur janë individual. Po ne vet i sjellim në këshill relacionet e projekt vendimet për ti miratuar.

- Pika e katërt e rendit të ditës: Projekt vendim " Për miratimin e raportit të performancës së Këshillit bashkiak Memaliaj për vitin 2024".

Nuk ka diskutuame.

Hidhet në votim.

Votohet unanim. Miratohet.

- Pika e pestë e rendit të ditës: Projekt vendim " Mbi dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 0-31 janar 2025".

Esmerald Xhemali: Ne si komision u mbledhëm dhe nuk kemi asnjë paqartësi . Jemi pro.

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Taulant Rama: Pse ndryshojnë shumat kur dy familje kanë të njëjtin numër antarrëesh në certifikatë familjare?

Laora Hoxha: Shumën e llogarit sistemi.

Xh.Kacorri :Pse Leonardo Dedëgjoni ka dalë nga 6%?

Laora Hoxha: E ka nxjerrë sistemi me pikë të pamjaftueshme.

Hidhet në votim.

Vota Pro 10 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota.Miratohet

● Pika gjashtë e rendit të ditës: Projekt vendim " Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajt janar-shkurt 2025".

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Petrut Lumani: Shoh një emër në listë që është i shkruajtur gabim korrigjoheni., Klodian Goga.

Taulant Rama: Dervish Rama është shumë punëtor gjeni një mënyrë për ta punësuar, është në vështirësi ekonomike.

Anest Halili: 1.Nëse ke makinë lejohet 6%?

Laora Hoxha: Ne i bëjmë deklaratimet në sistem dhe sistemi bën përzgjedhjen.

2.A lejohen të jenë në këtë listë punonjësit e administratës?

Laora Hoxha: Nga verifikimet e mia nuk ka nëse ke dyshime, më thuaj.

Asqeri Muçoima: Dua informacion mbi pasqyrimin e këtyre listave në qendër të qytetit.

Hidhet në votim. Vjen në mbledhje Znj.Maltona Bërxi.

Vota Pro 10 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 1 votë. A. Halili. Miratohet.

●Pika shtatë e rendit të ditës:Projekt vendim " Për vendosjen në shtëpinë e të moshuarve ".

Xh. Kacorri: A ka të tjerë banorë të vetmuar?

Laora Hoxha: Ne jemi duke ndërtuar një databaze për të gjitha njësitë, për t'i evidentuar.

Nuk ka diskutuame të tjera.

Hidhet në votim.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 0 Vota

Vota Kundër 0 vota . Miratohet.

● Pika tetë e rendit të ditës. Projekt vendim " Për miratimin në parim për rritjen e numrit me 6(gjashtë)punonjës të strukturës së Sektorit të MZSH-së Bashkia Memaliaj. "

Z. Esmerald Xhemali: Ne si komision u mbledhëm dhe u njohëm me materialin dhe e shoh pak të paqartë . Se kuptoj pse duhet kaluar në këshill. Pse nuk i bëhet një shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së?

Relaton Znj. Xh.Kuçi:Duke qenë se prej 2015 jemi bashkia e vetme që kemi të njëjtin numër të punonjësve të MZSH-së, duam ta thyejmë këtë numër dhe pastaj të bëjmë kërkesë për fonde.

Erjon Sinanaj:Pse duhet vendim këshilli pa u bërë kërkesa?

Xh. Kuçi: Për të qenë më të sigurt do ti bashkangjisim vendimin e Këshillit për të përthithur këto fonde se kështu ka vepruar dhe Burreli dhe Kamza.

Esmerald Xhemali: Qënha 2015 ne paskemi mangësi. Pse na vjen sot?Çfarë është bërë 10 vjet?

Xh. Kuçi: Duke parë dhe praktika të ngjashme pse nuk duhet ta kaloni? Ju kaluat në këshill dhe praktikën e legalizimit të banesave.

Xh. Kacorri: 1.Nuk duhet parë me emocione , nëse nuk kanë bërë përçapje 10 vitet e kaluara nuk shoh ndonjë gjë të keqe, jam pro. Duhet të votoj këshilli ta mbështesim MZSH-në.

Anest Halili: Ne në dhjetor e kaluam strukturën e MZSH-së. Pse vjen sot ky projekt vendim?

Xh. Kuçi: Ne vijmë për të kërkuar leje në parim dhe pastaj në ministrinë e financave për shtesë fondi.

Asqeri Muçoima: Unë jam dakord jo 6 vende pune por 16 punonjës të shtohen por ajo që më shqetëson është mënyra se si bëhet më le një shije jo të mirë. Pse? Kjo kërkesë që nga korriku pse vjen tani, nëse do ta kishte sjellë që atëherë.

Xh. Kuçi: Ti nuk duhet të thuash pse e solle tani. Nëse nuk ka funksionuar një sektor nuk them gjë unë .Sot i shtojmë në parim këta punonjës.

Xh. Kacorri: Unë mendoj të mos mbetemi te pjesa ndëshkuese , hajde ti japim përparësi jo ta pengojmë. Unë jam të hapim 6 vende pune.

P.Lumani:Juriste he unë jam dakord por ju jeni duke humbur inteligjencën e këshillit duke mos qenë bashkëpunues e duke mos patur argument.Pse duhet ta ngremë votën pro pa u bindur?

T.Rama:I sillni në këshill pa u bindur vetë nëse ka bazë ligjore apo jo.Ta heqim fare nga rendi i ditës. Shkëlqim Goxhara/ MZSH: Nisur nga dinamika e shërbimit jemi nisur për të sjellë kërkesë në bashki për shtim punonjësish . Ne jemi në kushtet e strukturave minimale.E kemi bërë kërkesën me e_mail se kështu na është kërkuar.

P.Lumani:A ka bazë ligjore?

Sh.Goxha:Jo nuk di gjë për këtë.

P.Lumani:Unë qëndroj te mendimi I taulantit ta heqim fare nga rendi i ditës.

A.Muçoima: Pse nuk bëni zë parën kërkesën dhe pastaj të vini këtu për shtim numri punonjësish? Hidhet në votim.

Vota Pro 4 vota F.M;L.L;XH.K;M.B.

Vota Kundër 5 Vota A.H;T.R;P.L;E.S;A.M.

Vota Kundër 2vota .E.XH;A.M Nuk miratohet.

Erjon Sinanaj: Nuk miratohet sepse jemi të pa qartë pasi të vijë kërkesa e miratuar nga ministria.

●Pika nëntë e rendit të ditës:Projekt vendim " Për miratimin e shpërndarjes së të ardhurave trashëguara të vitit 2024 për vitin 2025."

E:Xhemali:Ne si komision kemi bërë një propozim që buxheti i parealizuar nga këshilli për vitin 2024 ti shtohet buxhetit të këshillit për vitin 2025.Financa e ka marrë parasysh dhe ka ardhur në këshill I ndryshuar ..Jemi pro aktiv për këtë projekt vendim ne si komision.

Relation Z.B.Caushi sipas relacionit bashkangjitur .

Diskutime:A.Muçoima:Mbikqyrësi 3-7% të vlerës së projektit ,pse na e sjell prapë ne e kemi kaluar njëherë?

Xh.Kacorri:Unë ndihem I shqetësuar si banor I zonësduke marr parasysh se qyteti nuk ka një treg fruta-perimesh.Dua urgjentisht të të filloj ndërtimi I këtij tregu.Hiqe blerjen e një betonierje .fermerët po tregëtojnë në kushte fare të pasigurta ,në rrugë.Nuk është ky standardi që këta banorë meritojnë, atë meritojnë të kenë një treg me standarde.

B.Caushi: Mos u ngatërroni me mbikqyrjen se janë kaluar ,kjo është për çështje të thesarit .Tregu nuk bëhet me 1 mil lekë edhe nëse e heqim betonieren.

Hidhet në votim. Largohet nga mbledhja M.Bërxi:

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 0 Vota

Vota Kundër 1 vota . E.Sinanaj Miratohet.

Vjen në mbledhje Rita Çibuku.

Erjon Sinanaj I jep fjalë përfaqësueses së Margarita Sh.p.k.

Margarita Çibuku : Kam ardhur për vendimin tim sepse ai vendim ka dal nul sepse prefekti është shprehur : ka thënë është me karakter individual unë jam juridik.Juristja e justifikoi që I është hapur rruga dhe duhet kthyer për rishqyrtim sepse është zbardhur individual.Pse nuk e keni future në rend dite për rishqyrtim.

Erjon Sinanaj: Një vendim futet në rend dite për rishqyrtim kur nuk konfirmohet nga prefekti dhe vjen i njëjtë me të njëjtin objekt vendimi. Ky projekt vendim që sillni ju sot nuk ka lidhje me atë që kemi miratuar. Juriste të lutem sqaroje zonjën.



Xh. Kuçi: Është një procedurë që nuk jam marrë unë dhe nuk kam dashur të jem pjesë e gjithë diskutimit po meqë jam punonjëse dhe përfaqësuesve di do të jap mendimin tim. Herën e kaluar ju keni marrë vendim ,prefekti e ka konfirmuar ,por me karakter individual.Ne vim sot me një relacion të rid he kërkoj ta fusni në rend dite.

Z.Erjon Sinanaj :Ky vendim është cilësuar me karakter individual.

Margarita Çibuku: Është cilësuar me karakter individual sepse kështu e ka hartuar zyra juridike .

Prefekti është shprehur me karakter individual dhe bashkia nuk mund ta zbatojë.

Erjon Sinanaj: Ky relacion nuk mund të futet në rend dite sepse nuk ka ardhur , vjen tani që mbledhja mbyllet.

Xh.Kuçi: Relacioni është në dorën time sepse sot është konkluduar .

Kryetari I këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Taulant Rama
2. Asqeri Muçoima
3. Arsola Muzha
4. Esmerald Xhemali
5. Anest Halili
6. Lauresha Lila
7. Petrit Lumani
8. Maltona Bërxhi
9. Xhevit Kacorri
10. Flamur Mushamati
11. Erjon Sinanaj

12. Erjon Sinanaj

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

